



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Nr. 01-111/02-34775

Gjakovë

Datë: 16.11.2021

Duke u bazuar në nenin 79, 80 dhe 82 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Komuna e Gjakovës bën:

SHPLLJE TË KONKURSIT

Titulli i vendit të punës:	1. Punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>shtëpiak</i>) në SHFMU “Pjetër Bogdani” 2. Punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>roje</i>) në Konviktin “Sadik Stavileci” 3. Punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>shtëpiak</i>) në SHML Gjmnazi “Hajdar Dushi” 4. Punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>shtëpiak</i>) në Konviktin “Sadik Stavileci”
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Departamenti/Drejtoria:	Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës:	Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës
Numri i Pozitave:	(4) katër
Titulli i mbikëqyrësit:	Drejtori i Shkollës/Konviktit
Grada/Koeficienti:	Sipas koeficientit 4.0
Kohëzgjatja e emërimit:	Tre pozitë e para për kohë të pacaktuar, pozita e katërt me afat të caktuar për një vit shkollor

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligji.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Personeli shërbyes – teknik, ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë të përcaktuara në kontratën e punës dhe Rregulloren për Institucionet Edukative – Arsimore të Komunës së Gjakovës numër 01-110/05-11032 të datës 05/05/2017, dhe detyrat të tjera që ia jep mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Shkollimi i kërkuar: Shkollimi i mesëm

Dokumentet e kërkuara:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Diploma mbi kualifikimin e noterizuar;
- Diplomat e leshura nga Institucionet Shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje);
- Certifikatën nga Gjykata se nuk është nën hetime (origjinali);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje.

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data **16.12.2021** deri me datë **30.12.2021** (16:00).

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren në Qendrën e Informimit, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Pranimit apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë.

Rezultatet shpallën në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/>

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.